

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Padia për 5.2 milionë eurot dhe vila 14 milionëshe: historia e zhigolos së akuzuar për mashtrimin e vejus hës në Manhattan
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/padia-per-5-2-milione-eurot-dhe-vila-14-milioneshe-historia-e-zhigolos-se-akuzuar-per-mashtrimin-e-vejushes-ne-manhattan/1017801/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 17:06:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 17:02:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fbfccf0ef1aa0f870005f79096d754aa678b886bf7f72ba59011b61f5fd48be5
TEKSTI	bcd8a201a6df29c4204382fa92b2531ec8ee6a169a7e916825a65833979ad999
PAMJA	4d02acde9e9a4506da6a8dfb6785d2b56a1c61dec78db45623440170168722

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dfd3f4c866e41aa54241290b957570ae00afecb4baff75f05ee86395d01551d7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	0188b89a08595528a7763f43617734e52df4cad134485b32e03065e5637ea5a1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/dfd3f4c866e41aa54241290b957570ae00afecb4baff75f05ee86395d01551d7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Padia për 5.2 milionë eurot dhe vila 14 milionëshe: historia e zhigolos së akuzuar për mashtrimin e vejushës në Manhattan



Një konflikt gjyqësor është hapur mes Craig Starr, një zhigolo 38-vjeçar, dhe Marian Flipo, 49 vjeçe, nga Nju Jorku. Flipo e akuzon Starr se e mashtroi dhe i mori 5.2 milionë euro.

Çështja është shoqëruar edhe me publikimin e fotografive dhe videove që tregojnë ndryshimin në pamjen e Starr pas disa ndërhyrjeve estetike.

Materialet u shfaqën në llogaritë e kirurgut plastik Jason Emer. Ato paraqesin Starr para dhe pas procedurave, mes tyre liposuksion dhe ndërhyrje të tjera për formësimin e trupit dhe fytyrës. Emer e ka përshkruar rezultatin si pjesë të standardit estetik të quajtur prej tij "Maxoris".



Në një nga videot, Starr shfaqet i kënaqur me rezultatin dhe lavdëron kirurgun, duke thënë se ai kishte ndërthurur "saktësinë shkencore me artin dhe bukurinë".

të fundit /



Padia për 5.2 milionë eurot dhe vila 14 milionëshe: historia e...



Serbia lihet jashtë agjendës, von der Leyen udhëton në...



Yamal habit me rrëfimin për Rashfordin: "Nuk e kuptonte ende peshë..."



Flora Brovina përcillet me nderime shtetërore në banesën e fundit



Vëllai i Princeshës Diana trondit familjen mbretërore pas Princi...



Onkologu tregon pesë zakonet që shman në përditshmëri



Vllaznia kërkon pikët në "Loro Boriçi", Teuta zbret në Shkodër me...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Thelbi i padisë lidhet me marrëdhënien e Starr me Flipo-n. Ajo thotë se besonte se mes tyre ishte krijuar një lidhje romantike, por pretendon se Starr dhe persona të lidhur me agjencinë e eskortave e manipuluan për t'u dhënë miliona dollarë.

Sipas dokumenteve të paraqitura në gjykatë, gjithçka nisi në dhjetor të vitit 2024, disa muaj pasi Flipo kishte humbur bashkëshortin e saj, Chad Flipo. Çifti kishte qenë i martuar për 28 vite dhe kishte tre fëmijë.



Flipo vuante nga një sëmundje e rrallë gjenetike dhe, për shkak se duhej të udhëtonte në Itali për trajtim, kërkoi një shoqërues që të fliste italisht.

Përmes një të njohuri, ajo u lidh me kompaninë "Cowboys 4 Angels". Në padi thuhet se Flipo fillimisht mendonte se kompania ofronte asistentë personale, jo shërbime eskortash. Për udhëtimin ajo pagoi rreth 27 mijë dollarë dhe aty u takua me Craig Starr.

Flipo pretendon se gjatë qëndrimit në udhëtim ata fjetën në dhoma të ndara, por pas kthimit në SHBA vazhduan të komuniknin. Sipas saj, marrëdhënia më pas mori karakter personal.



Deri në dhjetor 2025, Starr ishte vendosur në shtëpinë e saj në Nju Jork, ndërsa Flipo kishte paguar më shumë se 450 mijë dollarë që ai të punonte vetëm për të.

Më 30 prill 2026, Flipo bleu për rreth 14 milionë euro një rezidencë historike në Manhattan. Avokati i saj thotë se ajo e mori pronën me synimin për të jetuar aty bashkë me Starr.

Prona, e njohur si Lanier House, është një rezidencë gjashtëkatëshe e ndërtuar në vitin 1903 në stilin Beaux-Arts. Ajo përfshin rreth 1,081 metra katrorë, 12 dhoma gjumi, më shumë se nëntë banjo, një bodrum vere, një ashensor prej druri dhe një hapësirë mirëqenieje me pishinë të ftohtë e sauna prej kedri.





Avokati Larry Hatcher ka deklaruar se blerja e rezidencës ishte e lidhur drejtpërdrejt me marrëdhënien e dy personave.

Një element qendror i mosmarrëveshjes është marrëveshja që Flipo pretendon se u shty të firmoste, në mënyrë që Starr të largohej nga agjencia e eskortave dhe të vazhonte lidhjen me të.



Sipas saj, dokumenti parashikonte një shumë prej 8.6 milionë eurosh dhe u nënshkrua gjatë një udhëtimi në Atlanta, në një kohë kur ajo po rikuperohej nga një ndërhyrje kirurgjikale dhe po merrte medikamente të forta.

Flipo fillimisht u përpoq të transferonte të gjithë shumën, por banka e anuloi veprimin për shkak të dyshimeve për mashtrim. Më vonë, sipas padisë, ajo kaloi 5.2 milionë euro në një llogari të përbashkët me Starr.

Flipo thotë se Starr transferoi më pas 4.9 milionë euro nga ajo llogari në një tjetër që ishte nën kontrollin e tij.

Pas kësaj, ajo kërkoi ndihmën e një avokati për të shqyrtuar marrëveshjen dhe ngriti padi në Gjykatën Supreme të Manhattanit, ku kërkon kthimin e parave.

Starr i ka hedhur poshtë akuzat dhe ka paraqitur një tjetër version të ngjarjeve.

Në një deklaratë për "New York Post", ai tha se fondet u përdorën për shpenzimet personale, shpenzimet e përbashkëta të çiftit dhe donacione bamirësie. Sipas tij, nga paratë kishin mbetur rreth 2.6 milionë euro.

Ai mohoi gjithashtu se e kishte detyruar Flipo-n të firmoste marrëveshjen.

"Doja të kisha siguri financiare. Doja të largohesha nga agjencia dhe të përpiqesha vërtet të kisha një lidhje, sepse isha i dashuruar me të më shumë se çdo gjë tjetër", deklaroi Starr.

Starr pretendoi se edhe ai kishte qenë viktimë e sjelljes abuzive të Flipo-s, ndërsa lidhjen e tyre e cilësoi si një "aventurë të çmendur".

Todd Spodeck, avokati i Starr, tha se padia pasqyron vetëm versionin e Flipo-s. Sipas tij, provat e procesit do të ndihmojnë në përcaktimin e asaj që ka ndodhur në të vërtetë.

Procedurat gjyqësore vijnë dhe pretendimet e të dyja palëve pritet të shqyrtohen gjatë procesit.

Shtuar më 18.09.2026 19:02





Anthropic hap laborator biologjie në përpjekje për të përdorur AI-në në kërkimi...



Vëllai i Princeshës Diana trondit familjen mbretërore pas Princit Harry: Charle...



"Më telefonoi dhe dukej shumë i lumtur", Earl Spencer rrëfen deklaratë...



Nigeri: 49 të vdekur dhe 182 të shtruar në spital pas konsumimit të alkoolit të...



VIDEO/ Sherr i dhunshëm në avionin nga Bangladeshi drejt Londrës, dy pasagje...



Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare Peter Max, artisti i ngjyrave të "Flowe...



Pas humbjes në Saksoni-Anhalt, Merz thërret drejtuesit e CDU-së për t...



Shaheen paralajmëron për luftën hibride ruse: NATO të vëzhgojë nga afër Ballkanin



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.